



Republika e Kosovës - Republika Kosova
Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborna komisija za žalbe i molbe

A nr. 160/2010

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (KZAP), në panelin e përbërë nga Muharrem Shala, kryesues, Fahredin Ymeri dhe Ymer Hoxha, anëtarë, duke vendosur përkritazi me apelet e z. Qerim Gara në cilësinë e bartësit të listës, nga subjektit politik Bashkimi Demokratik i Ashkalive (BDA) dega në Fushë Kosovë, dhe z. Danush Ademi në cilësinë e kryetarit të subjektit politik Partia Demokratike e Ashkalive të Kosovës (PDAK), paraqitur kundër vendimit të KZAP-it, Anr.75/2009 datë 19.04.2010, në seancën e panelit të mbajtur me 21.05.2010, mori këtë:

VENDIM

Apelet për rishikim refuzohen si të pabazuara.

ARSYETIMI

Bashkimi Demokratik i Ashkalive të Kosovës (BDA) ka parashtruar një apel kundër vendimit të KZAP-it, Anr.75/2009 datë 19.04.2010, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale – Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Lokale nr. 03/L073 dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike. Sipas parashtruesit të apelit nga kandidat i BDA-së, nuk ka pasur për qëllim pengimin e masës për të bërë fushatë, por është e vërtetë se ai ka kaluar me veturë pran masës, me çka kanë pasur kujdes të madh për sigurinë e tyre. Nuk ka qenë e qëllimi të pengojnë por është keqkuptuar për shkak se vetura e tij ka qenë me logon e subjektit politik BDA.

Për më tepër, në apel thuhet se është marrë iniciativë dhe është arritur marrëveshje që subjekti politik BDA të shkrihet në subjektin politik PDAK

Partia Demokratike e Ashkalive të Kosovës (PDAK) ka parashtruar një apel kundër vendimit të KZAP-it, Anr.75/2009 datë 19.04.2010, në të cilin theksohet se vendimi i ankimuar është marr me vonesë, ngjarje kjo e cila ka ndodhur para 5 muajve dhe është adresuar në subjektin i cili tani nuk ekziston dhe i cili nuk ka pasur buxhet. Në mungesë të buxhetit kanë vendosur që të bëjnë shkrirjen e subjektit politik BDA në PDAK, pas marrëveshjes së përbashkët në mes të këtyre dy subjekteve politike. z. Halil Qerimi në cilësinë e bartësit të listës nga subjekti politik PDAK, në apel thekson se do të tërheqë të gjitha lëndët të adresuara në gjykatë lidhur me këtë çështje ngase sipas tij ishte një hap i ngutshëm pasi z. Qerim Gara gjatë vozitjes së minibusit me posterat e BDA-së, nuk ka pas për qëllim pengimin por ka qenë në aktivitetet e fushatës.

Për më tepër, ky subjekt politik kërkon që të bëhet anulimi i këtij vendimi duke pasur parasysh se është bërë shkrirja e BDA-së në PDAK duke përmbushur obligimet ligjore.

FAKTET

Më 21.04.2010, KZAP ka pranuar dy apele me shkrim nga subjektet politike BDA dhe PDAK, me të cilët kërkohet rishqyrtimi i vendimit të KZAP-it A nr. 75/2010 të datës 19.04.2010.

Ky vendim ishte bazuar në faktin që subjekti politik BDA, ka bërë shkeljen e Rregullës NR.11/2009 "Kodi i Mirësjelljes për Subjektet, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët" neni 3 pika 1 për çka iu ishte shqiptuar gjoba në shumën prej 2900 (dymijë nëntëqind) euro, si dhe bartësit të listës z. Qerim Gara së bashku me të birin e tij Bekim Gara nga subjekti politik BDA, duke u bazuar në nenin 120 paragrafi 3 pika d, të LZP-së, iu ishte ndaluar për dy vite pjesëmarrja aktive në zgjedhje.

Gjatë hetimeve të këtij rasti me kërkesën për fillimin e procedurës për kundërvajtje me nr. të lëndës 2010AE00046, në Stacionin Policor në Fushë Kosovë, në këtë raport është theksuar se "bazuar në deklarata dhe konsultim me prokuror është vendosur që të iniciohet procedura ndaj këtyre personave për shkak të dyshimit se kanë kryer kundërvajtje, prishjen e rendit dhe qetësisë publike duke provokuar masën dhe vet liderin e kësaj mase më datë 09.11.2009 në Fushë Kosovë".

Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim, pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve konfirmon me shkresë zyrtare nr.392 datë 22.04.2010, se: është bërë unifikimi i subjekteve politike pra shkrimja e BDA-së në PDAK .

ANALIZË

Jurisdiksioni i KZAP'it lidhur me ankesat është caktuar në pajtim me kompetencat e dhëna nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në *Ligjin mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës – LZP* (Ligji nr 03/L- 073) dhe *Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën Kosovës* (Ligji nr 03 / L-072).

Në Rregullën Nr 01/2008, Neni 11.5 parasheh si vijon:

- a) e tërë pasuria dhe borxhet e Partive të bashkuara politike shëndrrohen në pasuri dhe buxhet të partisë së re politike,
- b) të gjithë anëtarët e partive politike të bashkuara bëhen anëtarë të partisë së re politike

Prandaj, në rastin e apelit kundër vendimit të mëparshëm të marrë nga KZAP, parashtruesit nga subjektet politike BDA dhe ai nga PDAK, të cilët kanë kërkuar që të rishikohet vendimi A nr. 75/2010 i datës 19.04 2010 të KZAP-it, apelet refuzohen si të pabazuara.

Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë

A nr. 160/2010 më datën 21.05.2010.



Kryesuesi i Panelit

Muharrem Shala